

VENDIM
Nr. 278, datë 6.11.2025

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 198, DATË 15.8.2025, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘POWER ENERGY’ SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 25 mw”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.11.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 2779 prot., datë 4.11.2025, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 198, datë 15.8.2025, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Power Energy’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 25 mw”,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “Power Energy” sh.p.k.

- Shoqëria “Power Energy” sh.p.k., me vendimin nr. 198, datë 15.8.2025, është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 25 mw, për një afat 30-vjeçar.

- Në kuptim të sa përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, shoqëria përpara fillimit të operimit, duhet të depozitojë në ERE marrëveshjen e nënshkruar me shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a., për miratimin e pikës së lidhjes së centralit fotovoltaik me rrjetin e transmetimit.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Shoqëria “Power Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1923/11 prot., datë 22.10.2025, ka depozituar kopjen e njehsuar me origjinalin të marrëveshjes për lidhjen me rrjetin e transmetimit të parkut fotovoltaik “Power Energy Solar”, nënshkruar mes shoqërisë “OST” sh.a. dhe “Power Energy” sh.p.k. me nr. 676/10 prot., datë 20.10.2025 dhe ka kërkuar rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 198, datë 15.8.2025, në kuadër të plotësimit të kushteve të përcaktuara në vendim.

- Nga raportimi periodik i “OST” sh.a. për muajin shtator 2025, rezulton se ky central nuk ka filluar ende prodhimin e energjisë elektrike.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Në përputhje me pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 198, datë 15.8.2025, dhe me depozitimin nga shoqëria të marrëveshjes së nënshkruar me “OST” sh.a., rezulton se ky kusht është përmbushur.

- Për pasojë, pika 2 e dispozitivit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 198, datë 15.8.2025, vlerësohet të shfuqizohet.

- Gjithashtu, pika 5 e të njëjtit vendim, e cila përcakton se vendimi është objekt rishikimi në rast të plotësimit ose mosplotësimit të kushteve të pikave 2, 3 dhe 4, vlerësohet të ndryshohet për të reflektuar faktin që pika 2 është tashmë e përmbushur.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në mbështetje të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, meqenëse shoqëria “Power Energy” sh.p.k. ka përmbushur kushtin për depozitimin e marrëveshjes së nënshkruar me “OST” sh.a., pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 198, datë 15.8.2025, vlerësohet të shfuqizohet.

- Gjithashtu, pika 5, e vendimit nr. 198/2025, përcakton se: “Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të pikave 2, 3 dhe 4, të këtij vendimi dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.”.

- Në kuadër të plotësimit të pikës 2, pika 5 vlerësohet të bëhet: “Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të pikave 3 dhe 4 të këtij vendimi, si dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2, e vendimit të ERE-s nr. 198, datë 15.8.2025, shfuqizohet.

2. Pika 5, e vendimit të ERE-s nr. 198, datë 15.8.2025, ndryshohet si vijon:

“Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të pikave 3 dhe 4, të këtij vendimi, si dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.”.

3. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë shoqërinë “Power Energy” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OST” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

